



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO  
KOMUNA E GJAKOVËS  
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA



Nr. 01-112/02-988  
Datë 23.01.2024

Kryetari i Komunës së Gjakovës, duke u bazuar në nenin 13 dhe nenin 58 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenin 81 të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publik si dhe nenin 53 paragrafin 3 të Ligjit numër 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, me qëllim të formimit të Komisionit të Pranimit (Përzgjedhjes) për Shërbimin Publik për zhvillimin e procedurave të vlerësimit për grupin Specialist të Përgjithshëm të Shëndetit/Mjekësisë dhe grupit Specialist të Arsimit, vetëm për pjesën e mbetur të procedurave të rekrutimit me numër 01-111/01-23656 të datës 13.12.2023 dhe 01-111/01-22820 të datës 22.11.2023, me qëllim të mbarëvajtjes së tyre me datë 23.01.2024 nxjerrë këtë:

**V E N D I M**

1. Ndryshohet pika 2 e vendimit me numër 01-112/02-23674 të datës 13.12.2023 për formimin e Komisionit të Pranimit (Përzgjedhjes) për Shërbimin Publik për zhvillimin e procedurave të vlerësimit për grupin Specialist të Përgjithshëm të Shëndetit/Mjekësisë dhe pika 2 e vendimit me numër 01-112/01-22436 të datës 15.11.2023 për formimin e Komisionit të Pranimit (Përzgjedhjes) për Shërbimin Publik për zhvillimin e procedurave të vlerësimit për grupin Specialist të Arsimit, për zhvillimin e pjesës së mbetur të procedurave të rekrutimit me numër 01-111/01-23656 të datës 13.12.2023 dhe 01-111/01-22820 të datës 22.11.2023, me qëllim të mbarëvajtjes së tyre pasi që anëtari i komisionit z. Dervish Tahiri, siç mund të vërtetohet edhe nga vendimi për pushim vjetor i lëshuar përmes sistemit HRMIS gjendet jashtë shtetit dhe në pamundësi që të marrë pjesë në procedurat e rekrutimit që janë në zhvillim e sipër, i njëjti zëvendësohet në të dyja procedurat me nëpunësen Trumëza Lila Ukmata;
2. Pjesa tjetër e vendimit me numër 01-112/01-22436 të datës 15.11.2023 dhe vendimit me numër 01-112/02-23674 të datës 13.12.2023 mbetet e pandryshuar.

**Vendimi iu dorëzohet:**

- Komisioneve të Pranimit (Përzgjedhjes)
- Njësisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore
- Arkivit

Ardian Gjini

Kryetar i Komunës së Gjakovës